



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 14 maj 2020
Nr. ref.:RK 1561/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI225/19

Parashtrues

Kadri Bullut

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-17-0250-A0001, të 12 shtatorit 2019

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Kadri Bullut me vendbanim në Prizren (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin AC-I-17-0250-A0001, të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit të DHPGJS), të 12 shtatorit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 46 [Mbrojtja e Pronës], 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe nenet 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt], 13 [E Drejta për Zgjidhje Efektive] dhe 14 [Ndalimi i Diskriminimit], të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale], të Ligjit [nr. 03/L-121] për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve], të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 dhjetor 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 20 dhjetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha (anëtarë).
7. Më 30 dhjetor 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Kolegjit të Apelit të DHPGJS.
8. Më 29 prill 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Bazuar në dokumentacionin e bashkëngjitur, parashtruesi i kërkesës kishte qenë punëtor i ndërmarrjes N.SH. IFS\PROGRES-SUPRALLON në Prizren.
10. Më 3 korrik 1998, ndërmarrja në fjalë kishte marrë vendim për t'ia ndarë parashtruesit të kërkesës banesën prej 72,28 m² (në bazë të kërkesës së tij), në adresën Revolucioni i Tetorit llam.2E nr.8, në Prizren.

11. Sipas shkresave të lëndës vërehet se në vitin 1999 nga pushteti i atëhershëm parashtruesi i kërkesës ishte dëbuar nga banesa dhe në atë banesë ishte vendosur një person tjetër (i përkatësisë etnike serbe, i cili poashtu kishte pretendime ligjore mbi atë banesë). Pas përfundimit të luftës, parashtruesi ishte kthyer (vendosur) përsëri në banesë. Por pas një kohe të shkurtër, sipas parashtruesit të kërkesës, ai ishte detyruar ta lëshonte përsëri banesën si pasojë e presionit dhe ajo ishte uzurpuar nga një person tjetër.
12. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës i ishte drejtuar Agjencionit Kosovar të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), me kërkesë për dhënien e të drejtës për blerjen e banesës në bazë të drejtës së banimit.
13. Më 11 qershor 2013, Bordi i Drejtorëve të AKP-së, përmes vendimit nr.1704, refuzoi kërkesën për blerjen e banesës të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës.
14. Më 27 korrik 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (në tekstin e mëtejme: DHPGJS), kundër vendimit të AKP-së [nr.1704], të 11 qershorit 2013.
15. Në seancën dëgjimore të mbajtur në Kolegjin e Specializuar të DHPGJS, përfaqësuesi i AKP-së kundërshtoi padinë e parashtruesit, duke argumentuar se AKP kishte refuzuar kërkesën e paditësit (parashtuesit) për blerje të banesës, sepse kishte parashtruar një kërkesë të tillë edhe ne Habitat. Për më tepër, sipas AKP-së, parashtruesi nuk i kishte plotësuar kriteret ligjore që do t'ia lejonte atij të blinte banesën, gjegjësisht nuk kishte kontratën për përdorimin dhe posedimin e ligjshëm të banesës.
16. Më 25 prill 2017, Kolegji i Specializuar i DHPGJS, përmes Aktgjykimit C-II-13-0299-C0001, miratoi padinë e parashtruesit të kërkesës dhe vendosi që (i) anulohet vendimi i Bordit të Drejtorëve të AKP-së [nr.1704] i 11 qershorit 2013, dhe parashtruesit të kërkesës i njihet e drejta e blerjes së banesës; (ii) AKP urdhërohet që brenda afatit prej 3 muajsh me blerësin në këtë rast ankuesin të lidhë kontratë për shitjen e banesës prej momentit kur Aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm; (iii) nëse AKP në këtë rast si shitëse përkundër kërkesës së blerësit refuzon ose nuk lidhë kontratë brenda afatit të paraparë blerësi fiton të drejtën që në procedurë jashtë kontestimore të kërkojë nga Gjykata kompetente që të nxjerrë aktvendim i cili e zëvendëson kontratën; (iv) kompetenca lëndore për aktvendimin që zëvendëson kontratën e shitblerjes midis bartësit të së drejtës banesore dhe AKP-së në rast refuzimi ose mos aktivizimi nga ana e shitësit, në bazë të nenit 7.4 të Ligjit nr.04/L-061 është Gjykata Themelore kompetente në procedurë jashtëkontestimore”.
17. Në këtë Aktgjykim, Kolegji i Specializuar i DHPGJS arsyetonte, ndër të tjera, se: “Paditësi e ka një kontratë për bashkimin e fondeve për ndërtimin e bllokut të banesave pjesë e të cilit ka qenë kjo banesë. Sipas ligjit në fuqi të vitit 1997, kjo banesë i është ndarë paditësit me vendim [...] është qenësore për këtë lëndë, se fakti se, personit të cilit një vendim i tillë për ndarje të banesës iu është lëshuar ai nuk ka qenë i detyruar që të lidhe kontratë tjetër me BVI.”

18. Më 27 maj 2017, AKP ushtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS, kundër Aktgjykimit të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS, C-II-13-0299-C0001, të 25 prillit 2017, me pretendimin për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.
19. Më 12 shtator 2019, Kolegji i Apelit të DHPGJS, përmes Aktvendimit AC-I-17-0250-A0001, miratoi si të themeltë ankesën e AKP-së, ndryshoi Aktgjykimin e DHPGJS [C-II-13-0299-C0001] të 25 prillit 2017 si dhe hodhi poshtë padinë e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme.
20. Në arsyetimin e këtij Aktvendimi, potencohet se: *"[...] vlerësimi i Kolegjit të Specializuar lidhur me diskriminimin nuk është i bazuar dhe është në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe gjendjen e vërtetuar faktike. Kolegji i Apelit, ndër të tjera vlerëson se kjo çështje tashmë ishte vëndosur nga Habitët-i dhe vendimet tashmë janë të formës së prerë [...] rastet që janë vëndosur nga ish-Habitati duhet të trajtohen si çështje të gjykuara. Këtë çështje e ka vërtetuar edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin Ref. KI 104/10."*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit i DHPGJS, përmes Aktvendimit AC-I-17-0250-A001, të 12 shtatorit 2019, i ka shkelur të drejtat e tij të mbrojtura me nenet 46 dhe 102 të Kushtetutës, si dhe nenet 6, 13 dhe 14 të KEDNJ-së.
22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Kolegji i Apelit i DHPGJS nuk ka marrë për bazë se ai ishte larguar nga banesa e tij përmes masave të dhunshme dhe *"se nga provat dhe administrimi i tyre mund të vihet në konkludim fare lehtë se në atë kohë kjo banesë i është ofruar një qytetari serb, kurse ai ishte larguar dhunshëm nga banesa e tij me asnjë dokument dhe arsyetim të vetëm"*. Në lidhje me këtë ai thekson se *"Gjykata Kushtetuese të bëjë një analogji të kësaj çështje ku të merret parasysh se në korrik të viteve 1990 Qeveria e dhunshme e atëhershme e shpalli Ligjin mbi marrëdhëniet e punës nën rrethana speciale, pas të cilit si pasoje erdhi përjashtimi i mijëra punëtoreve Kosovar"*. Ai poashtu pohon se edhe pas luftës (në vitin 1999) ishte detyruar të lëshonte banesën për shkak të presioneve dhe në të ishte vëndosur një person tjetër.
23. Sipas parashtruesit të kërkesës, Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS është *"vendim i pakuptimtë dhe jo ligjor dhe më është privuar një e drejtë fundamentale ajo e drejta e pronës dhe banimit, andaj nga vendimi i marrë pretendojmë se janë shkelur të gjitha dispozitat ligjore e akteve dhe instrumenteve kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me pronësinë dhe banimin"*.
24. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se ndaj tij ka pasur diskriminim dhe ishte bërë padrejtësi sepse ishte privuar nga e drejta e tij *"për të hyrë në negociatë për shitblerjen e banesës"*.
25. Në fund, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë si në vijim:

“[...]kërkesën ta aprovojë si të pranuar dhe Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS me nr.AC-I.-17-0250-A0001 ta shpallë si kundërkushtetues.”

Pranueshmëria e kërkesës

26. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
27. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

28. Gjykata, më tej, i referohet neneve 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individ i mund të ngrejë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.

Neni 49 [Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor.[...]

29. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kërkesave, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; konteston një akt të një autoriteti

publik, përkatësisht Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS, AC-I.-17-0250-A0001, të 12 shtatorit 2019; ka saktësuar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur; ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj, si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit të përcaktuar ligjor.

30. Megjithatë, përveç këtyre kritereve, Gjykata po ashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], të Rregullores së punës, i cili në paragrafin 2 përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

31. Gjykata sjellë në vëmendje argumentin kryesor të parashtruesit të kërkesës se Kolegji i Apelit i DHPGJS nuk e kishte marrë parasysh faktin se ishte dëbuar nga banesa e tij dhunshëm edhe pse atij i ishte ndarë banesa nga ana e ndërmarrjes në të cilën kishte punuar.
32. Gjykata konstaton se, në thelb, të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës kanë të bëjnë kryesisht me shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të KEDNJ, si dhe shkelje të nenit 24 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së.

Pretendimet për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

33. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se, në thelb, parashtruesi i kërkesës ankohet se në rastin e tij Kolegji i Apelit i DHPGJS nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike, për arsye se nuk ka marrë parasysh faktin se ai ishte dëbuar dhunshëm nga banesa, pa asnjë dokument dhe asnjë arsyetim të vetëm.
34. Lidhur me pretendimet e lartcekura, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës e ka ndërtuar rastin e tij mbi baza ligjshmërie, përkatësisht mbi vërtetimin e gabuar të fakteve, për sa i takon largimit të tij nga banesa, si dhe interpretimin e gabuar të ligjit nga Kolegji i Apelit i DHPGJS, përfshirë edhe AKP-në si organ administrativ që fillimisht ka refuzuar kërkesën e tij për blerjen e banesës.
35. Gjykata rikujton se këto pretendime kanë të bëjnë me mënyrën sesi AKP dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS kanë konstatuar faktet e rastit dhe kanë bërë interpretimet përkatëse ligjore. Si të tilla, ato pretendime hyjnë në fushën e ligjshmërisë dhe, parimisht, nuk hyjnë në domenin e Gjykatës Kushtetuese (Shih, rasti KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35).
36. Në këtë drejtim, Gjykata thekson qëndrimin e saj të përgjithshëm se nuk është detyrë e saj që të merret me gabimet e faktit dhe ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të mbrojtura me Kushtetutë

(kushtetutshmërinë). Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “*shkallës së katërt*”, që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj. Në përputhje me praktikën e saj tanimë të konsoliduar, Gjykata rithekson se është roli i gjykatave të rregullta t’i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të ligjit procedural dhe material dhe se Gjykata Kushtetuese nuk mund të bëjnë vlerësime se pse një gjykatë e rregullt ka vendosur në një mënyrë të caktuar e jo në një tjetër (Shih rastin: *KI70/11*, parashtues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

37. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse në një proces gjyqësor, provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë zhvilluar në mënyrë të atillë që parashtuesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, vendimet e Gjykatës Kushtetuese në rastet: *KI13/19*, *KI70/11*; *KI06/17*; *KI 172/18*).
38. Mbështetur në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se arsyetimi i dhënë në Aktvendimin e Kolegjit të Apelit të DHPGJS është i qartë dhe pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu gjeti që procedurat para Kolegjit të Apelit të DHPGJS nuk ishin të padrejta apo arbitrare.
39. Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS e kishte hedhur poshtë padinë e parashtuesit të kërkesës si të pa pranueshme dhe kishte miratuar ankesën e AKP-së si të bazuar, ndërsa Aktvendimin e DHPGJS e kishte ndryshuar, për shkak se çështja tashmë ishte vendosur nga Habitati dhe vendimi është i formës së prerë.
40. Kështu, Kolegji i Apelit të DHPGJS, në aktvendimin e tij, kishte theksuar si në vijim:

*“Kolegji i Apelit ndër të tjera vëren se kjo çështje tashmë ishte vendosur nga Habitati dhe vendimet tashmë janë të formës së prerë. Kolegji i Apelit konsideron se rastet që janë vendosur nga ish- Habitati duhet të trajtohen si çështje të vendosura, apo të gjykuara. Këtë çështje e ka vërtetuar edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin Ref. *KI104/10* të datës 23 prill 2012 me të cilin ishte vendosur në rastet e ngjashme lidhur me kontestet banesore. Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se vendimet përfundimtare të Komisionit për Kërkesa Pronësore Banesore (Habitat), konform nenit 2.5 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23, janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe nuk janë objekt shqyrtimi nga asnjë organ tjetër gjyqësor apo administrativ në Kosovë.”*

41. Për më tepër, Gjykata vëren nga shkresat e lëndës se në përgjigjen e Agjencionit Kosovar të Pronës drejtuar AKP-së, thuhet se për pronën që është objekt i kontestit ka vendosur Agjensioni Kosovar i Pronës, përmes Vendimit HPCC/D204/2005 të 18 qershorit 2005. Me atë vendim ishte refuzuar kërkesa e parashtuesit të kërkesës, i cili vendim më vonë ishte vërtetuar edhe nga Komisioni i ankesave përmes vendimit HPCC/REC/61/2006, i cili vendim ishte i formës së prerë dhe në pajtim me nenin 2, paragrafin 5 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 nuk mund t’i nënshtrohej rishqyrtimit nga asnjë gjykatë apo organ administrativ në Kosovë.

42. Në këtë aspekt, Gjykata më tej konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se procedurat pranë Kolegjit të Apelit të DHPGJS kanë qenë të padrejta apo arbitrare, apo që të drejtat dhe liritë themelore të tij të mbrojtura me Kushtetutë janë shkelur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të së drejtës procedurale. Gjykata rithekson se interpretimi i ligjit është detyrë e gjykatave të rregullta dhe është çështje e ligjshmërisë (Shih, *mutatis mutandis*, rastet: KI63/16, parashtrues i kërkesës *Astrit Pira*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 gushtit 2016, paragrafi 44; KI150/15; KI161/15; KI162/15; KI14/16; KI19/16; KI60/16 dhe KI64/16, parashtrues të kërkesës *Arben Gjokaj, Hysni Hoxha, Driton Pruthi, Milazim Lushaku, Esat Tahiri, Azem Duraku dhe Sami Lushtaku*, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 nëntorit 2016, paragrafi 62).

Pretendimet për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës

43. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, si argument kryesor për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës, thekson faktin se Kolegji i Apelit i DHPGJS-së ka nxjerrë aktvendim të pakuptimtë dhe si rrjedhojë, ai nuk ka fituar të drejtën e blerjes së banesës.
44. Gjatë shqyrtimit nëse ka pasur shkelje të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, Gjykata duhet së pari të përcaktojë nëse parashtruesi i kërkesës ka “pronë” në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
45. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se, sipas praktikës së qëndrueshme të GJEDNJ-së dhe të Gjykatës Kushtetuese, “prona” në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së mund të jetë ose “pronë ekzistuese” ose “pasuritë”, përfshirë edhe kërkesat në lidhje me të cilat personi së paku ka “pritje legjitime” për realizimin e tyre (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Jantner kundër Sllovakisë*, të 4 marsit 2003, numër 39050/97).
46. Me këtë rast, Gjykata thekson se “pritja legjitime” duhet të jetë shumë më konkrete se sa vetëm shpresa, sado e arsyeshme mund të jetë, dhe duhet të bazohet në një dispozitë ligjore ose një akt ligjor, siç është vendimi gjyqësor (Shih aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Kopecký kundër Sllovakisë*, numri i kërkesës 44912/98 i 28 shtatorit 2004, par. 48-49;).
47. Duke iu referuar parimeve të lartpërmendura në lidhje me rastin konkret, Gjykata vëren se Kolegji i Apelit i DHPGJS kishte trajtuar ekskluzivisht kërkesat e ngritura nga parashtruesi me padi për përcaktimin e së drejtës pronësore.
48. Gjykata konsideron se nga sa më sipër rrjedh që parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur të kishte “pritje legjitime” që Kolegji i Apelit i DHPGJS do të nxjerrë vendim në lidhje me të drejtën e blerjes së banesës, meqë për rastin e tij kishte vendosur Agjensioni Kosovar i Pronës – Komisioni i Ankesave, përmes vendimit HPCC/REC/61/2006, i cili vendim ishte i formës së prerë, Si i tillë, në pajtim me nenin 2, paragrafin 5 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 nuk mund t'i nënshtrohej rishqyrtimit nga asnjë gjykatë apo organ administrativ në Kosovë.

49. Rrjedhimisht, meqenëse “pritja legjitime” duhet të bazohet në dispozitën ligjore ose një akt të caktuar ligjor, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar se ai ka një “kërkesë të realizueshme”, e cila do të përbënte “pronën” në kuptim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.
50. Prandaj, Gjykata konstaton se nuk ka shkelje të së drejtës në pronë sipas nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

Pretendimet për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës në lidhje me nenin 14 të KEDNJ-së

51. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konsideron se është diskriminuar me vendimin e kontestuar të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, pasi që *“jam privuar nga e drejta për të hyrë në negociata për shitblerjen e banesës”*.
52. Gjykata, para së gjithash dëshiron të rikujtojë se, si rregull i përgjithshëm, barazia para ligjit nënkupton trajtimin e barabartë të individëve që ndodhen në kushte dhe rrethana të njëjta apo të ngjashme, duke përfshirë edhe të drejtën e tyre për mbrojtje të barabartë me ligj. Megjithatë, barazia para ligjit nuk do të thotë që për një individ ose një kategori personash, që janë në kushte objektivisht të ndryshme, të ketë trajtim dhe zgjidhje të njëjta.
53. Për më tepër, praktika e GJEDNJ-së sqaron se, sipas kuptimit të nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), një trajtim diskriminues konsiderohet vetëm atëherë kur “ai nuk ka justifikim objektiv dhe të arsyeshëm”, që do të thotë se, ai nuk ndjek një “qëllim legjitim”, apo kur trajtimi nuk ka një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti “midis mjeteve të përdoruara dhe qëllimit që arrihet” (shih, për shembull gjykimin e 28 majit 1985 në çështjen *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Seria A, nr. 94, para 78).
54. Në këtë këndvështrim, Gjykata konsideron se aktvendimi i Kolegjit të Apelit të DHPGJS nuk përmban elemente të shkeljes së barazisë para ligjit, përkatësisht elemente të trajtimit të pabarabartë, siç pretendon parashtruesi i kërkesës. Për më tepër, asnjë nga bazat e kërkuara të nenit 24 të Kushtetutës, kur ky nen interpretohet në dritën e nenit 14 të Konventës, nuk e mbështesin pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e kësaj të drejte themelore, sepse, ai në asnjë mënyrë nuk dëshmon dhe argumenton se gjykatat e rregullta e trajtuan atë në mënyrë ta pabarabartë dhe diskriminuese (shih, ndër të tjera, rastin e Gjykatës KI173/18, parashtrues *Nijazi Pasoma*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 korrikut 2019, paragrafi 32).
55. Në fund, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 102 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNJ-së, por ai nuk ka argumentuar dhe arsyetuar këto pretendime. Për më tepër, Gjykata vë në pah se pretendimi për shkelje të nenit 102 mund të ngritët në mënyrë të argumentuar nga parashtruesit individual, vetëm në ndërlidhje me ndonjë të drejtë specifike të garantuar nga Kapitulli II dhe III të Kushtetutës. Prandaj, ky nene në mënyrë të pavarur nuk mund të zbatohet nëse faktet e çështjes nuk bien në fushën e veprimit të paktën të njërës ose më shumë dispozitave të Kushtetutës që kanë të bëjnë me “*gëzimin e të drejtave dhe lirive të njeriut*” (shih, rastin KI 67/16, parashtrues i kërkesës

Lumturije Voca, Aktvendimi për Papranueshmëri, i 23 janarit 2017, par. 128; KI172/18, parashtues Arbër Kryeziu, pronar i "Al-Petrol" Sh.p.k, Aktvendim për Papranueshmëri i 20 janarit 2020, paragrafi 65).

56. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se parashtuesi i kërkesës nuk është i kënaqur me rezultatin e Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të DHPGJS, apo vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës, nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtuesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (Shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33; KI68/17, *Hysni Bytyqi*, Aktvendim për papranueshmëri i 4 qershorit 2018, paragrafi 32; dhe KI99/19, parashtues *Persa Raičević*, Aktvendim për Papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 51).
57. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh pretendimet e ngritura nga parashtuesi i kërkesës dhe faktet e paraqitura nga ai, Gjykata duke u mbështetur edhe në standardet e vendosura në praktikën e vet gjyqësore në raste të ngjashme dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, konstaton që parashtuesi i kërkesës nuk ka dëshmuar dhe nuk ka mbështetur mjaftueshëm pretendimet e tij për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ.
58. Prandaj, në pajtim rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, ajo duhet të shpallet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 29 prill 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arteta Rama-Hajrizi